Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e të Rinjve

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА, ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ - СКОПЈЕ
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE E DEMOGRAFISË DHE E TË RINJVE - SHKUP

Бр. / Nr. 08-4531/1
13-06-2025 20 год. / viti

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë

ÇMIMI PËR PJESËMARRJEN E TË RINJVE

THIRRJE PËR NOMINIME

I. RRETH ÇMIMT

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve (MPSDR) në bashkëpunim me Këshillin Nacional Rinor të Maqedonisë (KNRM) ndan Shpërblimin e këtij viti të Pjesëmarrjes së të Rinjve. Çmimi ndahet në tre kategori: kategoria individuale (të rinj të moshës 15-29 vjeç), kategoria për grupe joformale të të rinjve (me të paktën 3 anëtarë) dhe kategoria për organizata rinore, organizata për të rinjtë dhe organizata ombrellë rinore. Çmimi synon të njohë dhe të vlerësojë punën e të rinjve në adresimin e çështjeve të ndryshme sociale.

Çmimi për Pjesëmarrjen e të Rinjve vlerëson iniciativat nga të rinjtë, grupet joformale të të rinjve dhe organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe organizatat ombrellë rinore që demonstrojnë pjesëmarrje aktive të të rinjve, ndikim social dhe qëndrueshmëri dhe sjellin rezultate të matshme në përmirësimin e komunitetit ose mirëqenies së shoqërisë përmes aktiviteteve të të nominuarit.

II. KATEGORITË E ÇMIMEVE

Do të ndahen 3 Çmime, shpërblimi sipas kategorisë:

1. **KATEGORIA INDIVIDUALE E TË RINJVE (MOSHA 15-29 VJEÇ)**
2. **KATEGORIA E GRUPEVE INFORMALE TË TË RINJVE (ME TË PAKTËN 3 ANËTARË)**
3. **KATEGORIA E ORGANIZATAVE RINORE, KATEGORIA E ORGANIZATAVE PËR TË RINJTË, DHE ORGANIZATAVE OMBRELË RINORE**

III. KUSHTET PËR NOMINIM

Të rinjtë e nominuar në kategorinë individuale dhe anëtarët e grupit joformal të të rinjve të nominuar për Çmimin e Pjesëmarrjes Rinore duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

- Të jenë **shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut** ;
- Të jenë **të moshës 15 deri 29 vjeç deri në ditën e mbylljes së thirrjes për nominime;**
- Të kenë zbatuar aktivitetin, punën ose shërbimet për të cilat janë nominuar **në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;**
- Të kenë zbatuar aktivitetin, punën ose shërbimet për të cilat janë nominuar në periudhën **qershor 2023 - maj 2025;**
- Të dëshmojnë se ata luajn **rolin kyç** në aktivitetin për të cilin janë nominuar.

Organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe organizatat rinore ombrellë të cilat janë të nominuara për Çmimin e Pjesëmarrjes Rinore duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jetë **shoqatë ose fondacion i regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut** në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet;
- Të jetë i regjistruar si një nga format e organizimit rinor **në Regjistrin e Formave të Organizimit Rinor të AMS-së,** në përputhje me Ligjin e Pjesëmarrjes Rinore dhe Politikave Rinore;
- Të kenë të paktën **dy vjet ekzistencë aktive;**

Nëpunësit shtetëror, të emëruarit politikë, stafi i ndërmarrjeve publike dhe/ose udhëheqësit e partive politike nuk mund të jenë të nominuar për Çmimin e Pjesëmarrjes së të Rinjve.

IV. KRITERET PËR NOMINIM

Kandidatët idealë për Çmimin e Pjesëmarrjes së të Rinjve:

- Të demonstrojnë përkushtim dhe kontribut të jashtëzakonshëm në përmirësimin e jetës në shoqëri;
- Demonstrimi i pjesëmarrjes së fuqishme të të rinjve, lidershipit dhe përfshirjes aktive të të rinjve në zbatimin e aktivitetit;
- Të kenë ndikim të dukshëm në politikat dhe ndryshimet rinore në nivel lokal dhe/ose kombëtar;
- Zbatimi i zgjidhjeve afatgjata dhe të qëndrueshme për sfidat shoqërore;
- Të demonstrojnë potencial për rritje dhe përsëritjen e iniciativës;
- Janë të njohur midis bashkëmoshatarëve dhe komunitetit të gjerë;
- Të zbatojnë qasje kreative dhe inovative për përfshirjen e komunitetit në zgjidhjen e çështjeve sociale;
- Të zhvillojnë ose mbështesin mundësi për të rinjtë që të marrin pjesë në aktivitete që japin kontribut pozitiv në shoqëri dhe zhvillimin e tyre;
- Përfshirja e personave në rrezik social në përpjekjet për të të zgjidhur çështjet sociale;
- Ndërmarrja e veprimeve të cilat sjellin zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme për çështjet sociale;

Nuk do të merren në konsideratë nominimet për aktivitetet e kryera nga individë ose grupe që përfshijnë:

- Mbështetja ose lobimi në emër të një partie politike;
- Aktivitete fetare;
- Hulumtim akademik ose punë për zhvillim personal profesional.

V. ÇMIMI

VI. Çmimi synon të njohë dhe vlerësojë punën e të rinjve në adresimin e çështjeve të ndryshme sociale, dhe mbështetja financiare do të sigurojë avancimin e punës dhe aktivizmit të fituesit. Shuma e Çmimit për Pjesëmarrje të të Rinjve sipas kategorive është si vijon:

- 1,000 EUR **për kategorinë individuale;**
- 3,000 EUR **për grupet joformale të të rinjve**; dhe
- 3,000 EUR për **organizatat rinore.**

VII. UDHËZIME PËR PARAQITJEN E NOMINIMEVE

Nominimet për secilën kategori mund të dorëzohen nga individë, organizata, institucione, sektori i medias, sektori i biznesit ose anëtarë të tjerë të komuniteteve. Çmimet do t'i ndahen publikut të gjerë në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë (12 gusht 2025) në Shkup.

Paraqitjen e nominimit tuaj mund ta kryeni në linkun e mëposhtëm:

➢ **NOMINIMI PËR ÇMIMIN E PJESËMARRJES SË TË RINJVE 2025**

Afati i fundit për dorëzimin e nominimeve është **30 qershor 2025, ora 23:59.**

VIII. KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Pasi të përfundojë procesi i nominimit, të gjitha aplikimet do të shqyrtohen sipas kritereve teknike, me qëllim që të përcaktohet nëse ato i plotësojnë kërkesat themelore për shqyrtim të mëtejshëm. Ky shqyrtim do të përfshijë konfirmimin nëse i nominuari është midis moshës 15 dhe 29 vjeç, nëse aktiviteti është kryer në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nëse është kryer në periudhën nga qershori 2023 deri në maj 202.

Nominimet që kalojnë me sukses shqyrtimin teknik do të shqyrtohen në detaje nga një komision vlerësimi, i cili do të zgjedhë një maksimum prej tre kandidatësh për kategori për fazën e mëtejshme të votimit publik online. Komisioni do të vlerësojë nominimet sipas kritereve të paracaktuara, të ndara në katër kategori:

Kategoria	**Kriteri**	**Totali i pikëve**
1. Pjesëmarrja e të Rinjve (më së shumti 40 pikë)	Lidershipi	15
	Përfshirja e të rinjve në zbatim	15
	Shumëllojshmëria (përfshirja e grupeve të ndryshme, përfaqësimi gjinor, etj.)	10

2. Ndikimi (më së shumti 30 pikë)	Mbështet të rinjtë e komuniteteve të margjinalizuara/target grupet e synuara	10
	Ndikimi në politikat rinore (lokale/kombëtare)	10
	Angazhimi qytetar dhe ndikimi shoqëror	10
3. Qëndrueshmëria dhe bashkëpunimi (më së shumti 20 pikë)	Ndërmarrin veprime që sjellin zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme për çështjet shoqërore	10
	Arritja e bashkëpunimit me palët e tjera të interesuara	5
	Potenciali për rritje dhe përsëritje të iniciativës/aktiviteteve	5
4. Inovacioni (më së shumti 10 pikë)	Qasje kreative dhe inovative për zgjidhjen e çështjeve shoqërore	5
	Qasje kreative dhe inovative për përfshirjen e të rinjve	5
Totali i pikëve		**100**

IX. KORNIZA KOHORE

THIRRJE PËR NOMINIME MBI ÇMIMIN E PJESËMARRJES SË TË RINJVE	16 QERSHOR 2025
AFATI I PARAQITJES SË NOMINIMEVE	30 QERSHOR 2025
SHQYRIMI I NOMINIMEVE DHE PËRZGJEDHJA E RRETHIT TË NGUSHTË	1-7 KORRIK 2025
PROCESI I VOTIMIT PUBLIK ONLLAJN	**10 KORRIK – 31 KORRIK 2025**
NJOFTIMI PËR FITUESIT	1-5 GUSHT 2023

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Politikës Sociale,
e Demografisë dhe e të Rinjve

Këshilli Rinor Nacional
i Maqedonisë

MANIFESTIMI I NDARJES SË ÇMIMEVE PËR PJESËMARRJEN E TË RINJVE **12 GUSHT 2022**

* Datat e lartpërmendura mund të ndryshojnë